



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 32 , datë 29/04/2014

PËR

“MIRATIMIN E MODELIT TË KARTËS SË INSPEKTORIT”

Në zbatim të nenit 30, pika 4, të Ligjit Nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”:

URDHËROJ:

1. Modeli i kartës së inspektorit, të jetë sipas aneksit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Karta e inspektorit të tërhiqet pranë Inspektoratit Qendror, nga personi i autorizuar i Inspektoratit Shtetëror përkatës, ose nga vetë inspektori në detyrë me paraqitjen e kartës së identitetit (ID).
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, publikohet në Faqen Zyrtare të Inspektoratit Qendror www.inspektoratiqendror.gov.al, si dhe iu njoftohet Inspektorateve Shtetërore.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM

ILIR ZELA



ANEKS

1. Forma dhe përmasa e kartës

Trashësia e kartës: 0.51 mm deri në 1.02 mm

Lloji i kartës : CR80 dhe CR79 ISO PVC bosh

Dimensionet e kartës: ISO standard CR80 85.6 mm x 54mm or 3.375" x 2.125", dhe CR79
83.9mm x 51mm ose 3.303" x 2.051".

- **Pjesa para e kartës së inspektorit do të jetë me këtë përmbajtje:**

Stema e Republikës (në anën e majtë të kartës)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË (në mes të kartës)

Logoja e Inspektoratit Shtetëror (në anën e djathtë të kartës)

Në qendër fotoja e inspektorit

(Dhe poshtë fotos do të shënohen):

KARTE INSPEKTORI

Emër, Mbiemër:

Pozicioni:

Kodi:

Data e lëshimit:

- **Pjesa prapa e kartës së inspektorit do të jetë me këtë përmbajtje:**

Logoja e Inspektoratit Qendror (në mes të kartës)

(Poshtë logos do të jetë e shënuar)

**Inspektor i Përgjithshëm
INSPEKTORATI QENDROR**



Në mes të kartës do të shënohet ky paragraf:

“Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror”.


Në pjesën e poshtme të kartës do të shënohet: info@insq.gov.al
www.inspektoratiqendror.gov.al

KARTE INSPEKTORI

(Pjesa Para)

	REPUBLIKA E SHQIPËRISË	Logo Inspektoratit Shtetëror
		
KARTË INSPEKTORI		
Emër Mbiemër: Xxxxx XXXXXXX	Inspektor i xxxxx	
Pozicioni:	0000X	
Kodi:		
Data e lëshimit: xx.xx.2014		

(Pjesa Prapa)

 Inspektor i Përgjithshëm INSPEKTORATI QENDROR	<p>Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj. Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror.</p>	<p>info@insq.gov.al www.inspektoratiqendror.gov.al</p>
---	--	--